

Date: 6.1.2020

Drejtuar: Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare - AKEP

Lenda: Kthim pergjigje. Mbi zbatimin e detyrimeve per sigurine e komunikimeve elektronike.

Te nderuar,

Kompania KemiNet Shpk ju paraqet me poshte, Raportet e kerkuara nga AKEP per:

Politikat e dokumentuara te sigurise dhe implementimi i tyre lidhur me perpunimin e te dhenave ne sistemet tuaja dhe vecanerisht per te dhenat personale. Per mbrojtjen e te dhenave personale kompania KemiNet zbaton dhe respekton ligjin ne fuqi te miratuar nga Parlamenti Shqiptar Nr. 9887, dale 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 e te dhenave personale te klienteve te saj. Keto te dhena personale mbrohen dhe ruhen me nje kontrate dypaleshe midis kompanise KemiNet dhe klientit. Aneks kontrata per mbrojtjen e te dhenave dhe sigurine e sherbimit si bashkengjitur kesaj shkrese. - Masat e marra per te informuar perdoruesit per nje rrezik te vecante, menyren se si rreziku mund te reduktohet nga perdoruesit, si dhe kostot e mundshme qe duhet te mbulohen nga perdoruesi nese rreziku qe ndodhe eshte jashte masave qe mund te marre sipermarresi. Aneks Kontrata per sigurine e sherbimit te klientit si bashkengjitur. - Ne rastet e cenimit te te dhenave personale nese keni pasur njoftimet qe keni kryer ndaj abonentit dhe AKEP-in per keto konstatime. Kompania KemiNet nuk ka pasur raste te cenimit te te dhenave personale per klientet e saj. - KemiNet mban nje inventar me shkeljet e te dhenave personale, i cili permban fakte per keto shkelje, ndikimin e tyre dhe masat e ndermarra. Ne attach esht pikerisht tabela e rasteve.

Amendament per Garantimin e Sherbimit te Sigurte dhe mbrojtjen e te dhenave personale nga KemiNet

Kompania keminet ju garanton ofrimin e sherbimeve te sigurte dhe mbrojtjen totale ndaj sulmeve te jashtme, si dhe ruajtjen e te dhenave personale. Siguria e Sherbimeve te ofruara perfshin mbrojtjen e informacionit nga kercenimet e jashtme, ne menyre qe te sigurohet vazhdimesia e biznesit tuaj duke minimizuar rreziqet dhe duke rritur mundesite e biznesit. Ne rast demtimi te biznesit tuaj, si rrjedhoje e sulmeve te jashtme ne sherbimin qe Keminet ju ofron, ju do te demshperbleheni ne forma te ndryshme duke u bazuar ne shkallen e demtimit. Kompania KemiNet zbaton ligjin ne fuqi per Mbrojtjen dhe ruajtjen e te dhenave personale per te gjitha klientet e saj: Nr. 9887, date 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012. Te gjitha klientet e Kompanise KemiNet jane te sigurte se te dhenat e tyre personale jane ruajtur ne menyre kofidenciale dhe nuk behen objekt sulmi ose vjedhje nga pale te treta te cilat jane jashte kompanise KemiNet. Keminet disponon nje rregullore te mbrendshme ne lidhje me ruajtjen dhe perpunimin e te dhenave personale te attachuar me poshte.

Amendament per Sigurine e Informacionit ne Kompanine e KemiNet

Informacioni eshte nje aset .Si te gjitha asetet fizike ose jo te kompanise. Mjaft thelbesor per biznesin dhe si pasoje duhet te jete i sigurte. Informacioni mund te transmetohet ne disa menyra: mund te jete i printueshem ne leter. i ruajtur ne menyre elektronike. mund te transmetohet permes postes elektronike ose thjesht dhe gojarisht gjate nje bisede. Ne te gjitha menytrat, gjithmone duhet te transmetohet ne menyre te sigurt. Siguria e Informacionit eshte mbrojtja e informacionit nga kercenimet. ne menyre qe te sigurohet vazhdimesia e biznesit duke minimizuar rreziqet dhe duke rritur mundesite e biznesit. Nje informacion i sigurt arrihet duke zbatuar nje sere rregullash dhe procedurash qe nisin fillimisht me nje vete-disiplinim e gjithesecilit prej punonjesve. Elementet e Sigurise se Informacionit jane si ne skemen e meposhtme:



Cdo punonjes i kompanise KemiNet mban pergjegjesi te plote per informacionet te cilat arrin te aksesojne si edhe duhet te mundesojne uljen e rrezikut te kompanise ndaj sulmeve te jashtme qe sjellin demtime. Eshte asolutisht e NDALUAR qe cdo person i punesuar ne kompani me kontrate te rregullt pune, te nxjerre jashte kompanise informacione konfidendale qe mund te aksesojne ne vendin e tij te punes. Gjithashtu ka nje hierarki te mirefunksionuar te kalimit te informacionit brenda kompanis. Realizojme azhornimin e sistemeve dhe ndryshimin e herepashershem te paswordeve. KemiNet ka realizuar mbylljen e gjith faqeve te paligjshme te kerkuara nga autoriteti i AKEP. Ka marr masa per bllokimin e komunkimeve te paligjshme dhe qe cenojn te drejtat e autorit ne layer 3 dhe layer 7. Keminet ka dhe nje firewall ne emer te tij, i cili esht i vendosur neper klientet te rendesis se vecant.

Klasifikohen si informacione Konfidenciale cdo e dhene qe perfshin:

- a) Te dhenat Personale te Punonjesve aktuale dhe jo vetem ne Keminet ku perfshihen edhe Pagat e Punonjesve ose/dhe pagesat e sigurimeve per secilin punonjes.
- b) Lista dhe informacione te detajuara te Klienteve qe KemiNet disponon- cdo file qe ndodhet ne folder-at e Sales Department dhe CRM.
- c) Te dhenat financiare te kompanise- cdo file qe ndodhet ne folder-at e Finance Department
- d) Te dhenat teknike qe disponon departamenti i teknikes dhe qe ndodhen ne folder-at perkates te siguruar dhe enkriptuar nga persona pergjigjes.

e) Informacione qe disponon departamenti i Help Desk, rreth menyres qe ndjek per suportin e klienteve

f) Informacione dhe te dhena Konfidenciale qe ruhen ne folderin IMANAGMENT dhe ku ka akses vetem punonjesit ne postet menaxhuese te kompanise.

Integriteti dhe siguria e rrjetit KemiNet:

Rrjeti KemiNet eshte i perbere me pajisje te standarde bashkohore, shperndarja e tij eshte ne baze fibre dhe antene. Klienteve ju ofrohet nje shpejtesi e lart me fiber optike deri ne 100 mbps. Ndersa me antene varion nga 10- 60mbps ne brezin 5 ghz. Pajisjet e networkut keminet jane baze Cisco, Mikrotik dhe Juniper ndersa serverat HP Supermicro dhe Dell. Si provider bgp peer kemi me abcomin , Voxility, Tring, me fiber optike. Kemi futur edhe sistemin antiDDOS me partneret tane ne gjermani Voxility. Monitorimi I rrjetit behet me cacti , the dude dhe nagios system.

Pajisjet e rrjetit jane si me poshte:

Juniper Router Firwall Srx5600, SRX1400, Switche Juniper QFX5100, EX4300, Mikrotik – CloudCore, micronoc 7500 Mikrotik - micronoc 2200, Mikrotik – rb951, rb600, rb800, rb433, Mikrotik SXT lite 5, Nanostation3&5, Cisco - SPS 224G4, Cisco – sf300 48, Cisco – catalyst 2960, cisco1, cisco 1841 series, Firewall pfsense I diznjuar

nga keminet.. etj.






150Mbps



Serverat tipit HP proliant , Dell PowerEdge , coolermaster per sherbim hostimi apo vps

servers (Esxi server);





Topografia e lidhjes Serverave ne Rrjet

Kemi ne plan te afert per permisimin e corit te networkut me pajisje me te fundit.

Sistemi I billingut esht I nderthurur midis radius manager & CRM per klientet e internetit, si dhe whmcs per abonetet e hosteve dhe domaineve. Menaxhimi I hosteve nga klientet behet me ane te whm ft cpanel.

Siguria e sistemeve dhe pajisjeve:

Pajisjet e rrjetit dhe sistemi I serverave jane te izoluar ne datacenter ne kushte optimale me ajer te kondicionuar, ventilim, akses I autorizuar, sistem ups, gjenerator atomatik, sistem kunder zjarrit, Sistem sigurie dhe survejimi 24/7 , sisteme alarmi.

Mbrojtja e të dhënave personale te abonenteve:

Te dhenat personale te abonenteve do te jene te sigurta sepse kontratat dhe lista e abonenteve mbahen vetem nga Administratori. Ne sistemin Billing do te kete akses vetem nje person ndersa kompjuteri i tij , bllokohet qe te mos kete mundesi te dalin te dhenat personale te abonenteve. Roli i tij do te jete thjesht lexues dhe printues faturash. Ndryshimet ne sistemin Billing behen vetem nga Administratori.

Autorizimi I personelit:

Personeli esht I ndare ne hierarki dhe me nivele aksesi, Secili nga punonjesit ka pergjegjesin dhe autorizimin perkates. Ne rastet kur ka ndryshime ne personel behet heqja e te drejtave dhe roleve nga cdo akses local apo remote mbi pajisjet dhe sistemet. Punonjesit e rinj trajonohen per menaxhimin efikas te pajisjeve fizike dhe logjike. Ka nje rregullore per menaxhimin , ruajtjen * perdormin dhe updatimin e userave dhe paswordeve. Secili departament ka fushat e veta ne sistem.

Sherbimi i rrjetit ne rastet e gjendjes së emergjencës

Ne raste emrgjencash te shpallura nga Qeveria Shqiptare ose me Ligj, dhe ne raste lufte, Administratori do te vendose ne dispozicion te gjithë rrjetin e tij dhe te gjitha pajisjet e tij ne dispozicion te organeve shteterore qe do ngrihen per kete qellim ose qe do te ngarkohen me ligj per te ndjekur situatë te tilla. Keminet do te vendose ne dispozicion edhe punonjesit 24 ore qe

rrjeti dhe pajisje te tona tu sherbejne ketyre institucioneve. Gjithashtu do te veme ne dispozicion edhe mjete te tjera ndihmese, gjenatore, nafte etj. Mbrojtja e qytetareve ndaj veprimeve të dëmshme të rrezatimit elektromagnetik: Pajisjet tona nuk perbajne rezatim mpasi pajisjet jane te nje fuqie me pak se 1W, dhe po ashtu ato jane te vendosura ne maja te larta, larg kontaktit te me njerez.

Informimi I publikut ne raste te parashikuara dhe paparishikuara:

Kete detyrim per KemiNET e kemi parashikuar qe ne kontrate me abonetin. Ne cdo moment te informojme klientet tane edhe nepermjet sistemit dhe informimit me email ose sms ne lidhje me kufizimet ne aksesin internet, kohezgjatjen dhe oren sa me te sakt. Kompania keminet ofron dhe sitin online www.keminet.al per cdo informacion dhe mbajta e kontaktit me klientet ,

publikimin e tarifave, treguesit te cilesise, kontraten TIP dhe matesi i shpejtesise se internetit per kolientin speedtest.

Lejimi i Autoriteteve te ngarkuara me ligj:

Administratori lejon autoritetet publike dhe te ngarkuara me ligj pa asnje kufizim dhe pa asnje pagese per perdorimin e rrjetit dhe shërbimit internet, për të paralajmëruar publikun për kërcënimet e pashmangshme nga katastrofat e mëdha dhe për zbutjen e pasojave nga katastrofat e mëdha.

Lejimi i përgjimeve te ligjshme:

Keminet esht e hapur me strukturat e shtetit per procesimin e rasteve te dyshimta apo qe jan ne shkelje te ligjit, autoritetet perkatese e kane te garantuar lejimin per pergjimin e informacionit ne internet dhe do te bashkepusoje me keto institucione sa here ti kerkoet. Ne cdo rast ketyre autoriteteve do tu vihen ne dispozicion te gjitha pajisjet dhe infomacioni qe do u kerkoet.

Ruajtja dhe administrimin e të dhënave të pajtimtarët tane për qëllime të ndjekjes penale.

KemiNet do ti ruaje dhe administroje te dhenat e pajtimtareve ne menyre te sekretuar. Vetem organeve te ngarkuara me ligj do ti vihen ne dispozicion te dhenat e pajtimtareve per qellime te ndjekjes penale. per ruajtjen dhe administrimin e te dhenave te pajtimtareve (perfshire edhe per qellime te ndjekjes penale) ka pergatitur edhe Udhezuesin per punonjesit nje kopje te te cilit e veme ne dispozicion vetem te AKEP .

Informacione shtese per sigurine e rrjetit:

KEMINET, do të zbatojë masa teknike dhe organizative, për të realizuar sigurinë e rrjeteve dhe të shërbimit internet, të ofruara prej tyre sipas përcaktimeve të nenit 122 të ligjit nr. 9918 dhe rregullave të nxjerra nga AKEP-i. Kur te jete e nevojshme, në bashkëpunim me ofruesin e shërbimit internet do te merren masa te perbashketa teknike. Mbrojtja fizike e kablove eshte e garantuar me stafin aktual, mbrojtja e klienteve do te synohet me antiviruse free dhe pajisjve firewall ne klientet e rendesis se vecant. Mbrojtja logjike e rrjetit dhe sinjalizimet ne rrjet do te mundesohen nga pajisja DNS Server me Firewall, Antiviruse dhe Antimalware si dhe nga firewalli ne main router.

Numri i klienteve te KemiNet me akses broadband internet eshte : 90

Strategjia e Vazhimit të Shërbimit dhe Planet e Emergjencës

Keminet ka nje infrastrukture dhe strategji emergjente per vazhdimesin e biznesit. Kjo

konkludon ne radhe te pare ne dublikimin e te gjithë pajisjeve me te rendesishme te rrjetit dhe sistemeve, load balancing, failover, backupe periodike, ruajtjen e konfigurimeve ne disa kopje dhe ne vende te ndryshme te sigurta. Internetit eshte i garantuar nga disa providera BGP.

Sistemet e monitorimit Cacti, Dude, Nagios bejne te mundur monitormin dhe regjistrimin e problemeve si dhe lajmerim me email per zgjidhje ne kohe. Sistemi i troubleticket RedMine qe perdorim ndimon ne arkivimin dhe gjetjen e zgjidhjeve per probleme te ngjashme.

Gjithashtu kompania ka nje plan procedural per rastet e emergjences ne menyre qe koha e rikthimit te sherbimit te jet sa me e shpejt.



MASAT SANKSIONUESE NE RAST SHKELJE

Ne rast se kompania veren qe ndonje prej punonjesve ka nxjerre informacione konfidenciale

jashte vendit te tij te punes ne perputhje edhe me Legjislacionin ne Fuqi per Republikën e Shqiperise. NDAJ KETIJ PUNONJESI DO TE MERRËN MASA NDESHKUESE si me poshte:

1. Heqja e aksesit te menjehershëm ne te gjitha informacionet konfidenciale te kompanise.
2. Nderprerja e menjehershme e kontrates se punes prane kompanise KemiNET.
3. Ne varesi te rendesise se informacionit. ndaj punonjesit do te aplikohet nje gjobe.
4. Nese informacioni qe ka dale jashte kompanise eshte jetik per te. punonjesi do te denoncohet ne autoritetet perkatese te policise dhe prokurorise se rrethit Tirane.
5. Ne varesi te rendesise se informacionit punonjesi do te ndiqet penalisht edhe ne shkallet e Gjykates se rrethit Tirane.

Shpresojme ne zbatimin me perpikmeri te rregullave te mesiperme, nga ana e punonjesve te kompanise

Faqja web: www.keminet.al, Contact: office@keminet.net & support@keminet.net

tel: 0689028040 , zyrat qendrore : Rr. Abdi Toptani , Torre Drini , Kati 2, nr 28